**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2020**

**1.** Nxënësi/ nxënësja* merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: komunikimi

**2.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar dy elemente nga sa vijon: mesazhi, dërgimi i mesazhit, dërguesi, marrësi, simbolet, deshifrimi, informacionet kthesë/ lidhja/ fedback

**3.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar S dhe ka shkruar argumentimin: Fedback është një informacion kthesë, domethënë bashkëbiseduesi na kumton nëse dërgimi i mesazhit ka qenë i suksesshëm ose jo, dhe atë informacion kthesë nuk e kemi nëse mesazhin e dërgojmë përmes TV-së, radios, gazetave./ Nëse e dërgojmë përmes TV-së, radios, gazetave, nuk mund ta marrim informacionin kthesë./ Nuk e dimë nëse dërgimi i mesazhit ka qenë i suksesshëm./ Nuk e dimë nëse mesazhi ka qenë i deshifruar ose është kuptuar *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.
**Vërejtje:** Pranohet edhe nëse nxënësi nuk ka rrethuar as S dhe as P, por që nga argumentimi është e qartë se konstatimi është i saktë.

**4.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Mungon sugjerimi në gjithçka që mund të ndikojë në transmetimin e saktë të mesazhit, dhe ajo është zhurma fizike dhe psikologjike, përkatësisht nëse përgjigjja sugjeron për zhurmën fizike dhe psikologjike, përkatësisht zhurmat, ndjenjat, paragjykimet, dallimet në mes të brezave dhe ngjashëm.

**5.** Gjithsej **3 pikë**:
A) Është rrethuar përgjigjja nën 2: joverbal - *1 pikë*

B) Nxënësi merr *1 pikë* për një përgjigje pjesërisht të saktë në të cilën nuk sqaron termin dekodim, p.sh. Zemra tregon dashurinë, ose përgjigjja është e plotë, por pa stil.
Nxënësi merr *2 pikë* për një përgjigje të plotë dhe me stil, p.sh. Dekodimi është shndërrimi i simboleve në një informacion të kuptueshëm, në këtë shembull me zemër shprehet dashuria./ Simboli i zemrës është interpretuar dhe lexuar saktë si një dashuri, lumturi, gëzim./ Dikush na ka dërguar shenjën e zemrës, dhe ne atë shenjë e kemi dekoduar/deshifruar, d.m.th. interpretuar dhe kuptuar se na do, mbështet... *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.

**6.** Është rrethuar përgjigjja 2: *Vazhdoni, ju lutem* ***– 1 pikë***

---
*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

**7.** Është rrethuar përgjigjja 3: *vrasjen e Polonit* ***– 1 pikë***

**8.** Gjithsej **2 pikë:**

*1 pikë* për citimin e dëshmive për kuriozitete: p.sh. Vetëm tre aktor janë në shfaqje, kurse pjesëmarrësit tjerë janë njerëzit nga mjedisi ku luhet shfaqja, derisa porotë janë njerëzit nga publiku *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.

*1 pikë* për citimin e dëshmive për kreativitet: p.sh. Në shprehje vjen paraqitja në skenë, mënyra e drejtimit, intonacioni, aktrimi i njerëzve të cilët marrin pjesë në shfaqje, dhe nuk janë aktor por merren me punë të tjera: gjykatës, prokuror, avokat, polic./ Në mënyrë të pazakonshme janë të ndërlidhur teatri dhe e drejta në shfaqje *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.

**9.** Nxënësi merr ***1 pikë*** për një përgjigje plotësisht të saktë:

| | | |
|---|---|---|
| Avokati Petar Uçajev është aktor i Teatrit Popullor Serb. | S | (P) |
| Porota në Cyrih ka vendosur që Hamletit t'i paguaj 80 000 euro. | (S) | P |
| Gjykatësi Majiq ka marrë duartrokitje të fuqishme vetëm se e dënoi Hamletin me tre vjet burg. | S | (P) |

**10.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Ai ishte një rast fatkeq, Hamleti nuk e kishte për qëllim ta vriste Polonin./ Mendoi se pas perdes ishte një mi i madh./ Hamleti nuk kishte motiv që ta vriste Polonin dhe as që mund të supozonte se ky po fshihej dhe po endej pas perdes *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.

**11.** Është rrethuar numri *3: Virgjili* – ***1 pikë***

**12.** Gjithsej ***2 pikë*** **–** nxënësi merr *2 pikë* për përgjigje plotësisht të saktë:

*Fyelli* – e tepërt

*Albatrosi* – motivi i shëmtimit, bukuria e jetës dhe mizoria

*Iliada* – motivi heroik

*Çeta e profetëve* – motivi religjioz

*Hamleti* – motivi i hakmarrjes

Nxënësi merr ***1 pikë*** për 2 ose 3 përgjigje të sakta.

**13.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar saktë titullit e poemës dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj:
*Poema e mjerimit,* Millosh Gjergj Nikolla

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Në këtë poemë pamjet dhe fatet e njerëzve në skamje dhe në mjerim përshkruhen me një realizëm deri në lakuriqësi *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

**14.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Në këtë poemë mbizotëron revolta poetike *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

**15.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Lind padituri, përbuzje; Sjell trashëgimi të përçudnuar; Shkatërron fëmijërinë dhe ëndrrat e saj; Shkatërron vlerat dhe moralin; E çon njeriun në depresion, mjerim, etj.

**16.** Gjithsej ***2 pikë* –** nxënësi merr *1 pikë* për përgjigje nëse nuk sqaron përgjigjen ose nëse përgjigjja bazohet në njohjen e ndjenjës së personazhit, p.sh. Xha Gorio përfundon tragjikisht/ Është i zhgënjyer, i vetmuar/ Iluzionet e tij përfundojnë me dëshpërim, ose nëse përgjigjja është e plotë, por pa stil dhe e paqartë.

*Për një përgjigje të plotë dhe me stil, e cila përfshin pandjeshmërinë e vajzave për babain dhe ndjenjat e e Xha Gorios për shka të moskujdesit të tyre, 2 pikë* (P.sh. Dashuria e tij ndaj vajzave për shkak të cilave është i gatshëm që të bëjë gjithçka, mbetet e pakthyer./ Kur është në prag të vdekjes, e sheh se të bijat nuk çajnë kokën për të dhe mbetet i dëshpëruar *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

**17.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Ezhen de Rastinjak/ De Rastinjak/ Ezhen

**18.** Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:

**retrospektiva** - epika
**remarka** - drama
**rima** - lirika
**akti** - drama

**19.** Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:
**romantizmi** → R E A L I Z M I → **moderne**

**20.** Gjithsej ***3 pikë* –** nxënësi merr nga *1 pikë* nëse pranë vargjeve nga vepra shkruan saktë emrin e personazhit i cili i thotë ato:

1. Mustafa ***(1 pikë)***
2. Igumen Stefani ***(1 pikë)***
3. Vlladikë Danilloja ***(1 pikë)***

**21.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse përshkruan: narracioni

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Narracioni është një formë e të shprehurit artistik, kurse të tjerat janë figura stilistike *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

**22.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: *Formula e pagëzimit*

**23.** Është rrethuar numri *2: asimilimi* – ***1 pikë***

**24.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:
1. etj.
2. FMN
3. p.sh.

B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë

**25.** A) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: ndër mend
B) Nxënësi merr ***1 pikë*** për plotësisht të saktë: kallëzore

**26.** A) Është rrethuar numri *3: Aradi* – ***1 pikë***:
B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse argumenton përgjigjen nën A duke emëruar veprat letrare nga të cilat janë personazhet: Vetëm Aradi është nga vepra *Bardha e Tamalit,* kurse të tjerët janë nga vepra *Nga jeta në jetë – pse?!/ Të gjithë janë nga vepra Nga jeta në jetë – pse?!,* përveç Aradit i cili është nga *Bardha e Tamalit.*

**27.** Gjithsej ***2 pikë* –** nxënësi merr nga *1 pikë* nëse pranë vargjeve shkruan saktë figurën e intonacionit:

1. retiçenca (heshtja) ***(1 pikë)***
2. aliteracioni (përsëritja) ***(1 pikë)***

**28.** Gjithsej ***3 pikë***:
A) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Idealizmi absolut i atdheut dhe i vlerave fizike e shpirtërore të shqiptarëve *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*
B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan:

| **Gjergj Fishta** | **Naim Frashëri** |
|---|---|
| (autori *Gjuha shqipe)* | (autori *Bagëti e Bujqësi)* |

**29.** A) Është rrethuar numri 1: *Antigona* – ***1 pikë***:
B) Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Vizat në këtë varg janë përdorur për të veçuar fjalinë e ndërshtënë (ndërkallur) ose tregojnë një shkëputje të vogël.

**30. Skema për vlerësimin e esesë: Analiza e personazhit të plakës Nicë**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi shkruan se autori i këtij fragmenti është Ismail Kadare. ***(1 pikë)***<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi tregon se:<br>- romani nga i cili është fragmenti i veçuar titullohet *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* ***(1 pikë)***<br>- vepra përbëhet nga dy pjesë ***(1 pikë)***<br>- ngjarjet në këtë roman zhvillohen rreth një gjenerali italian, i cili është dërguar në Shqipëri për të gjetur eshtrat e ushtarëve të rënë italian gjatë kohës së pushtimit të Shqipërisë. ***(1 pikë)***<br><br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi shkruan për subjektin e pjesës së veçuar:<br>- ndjenjën e gjeneralit për ardhjen e plakës Nicë ***(1 pikë)***<br>- përshkruan ardhjen e Nicës si burrëreshë përpara gjeneralit ***(1 pikë)***<br>- vështrimin që i bën plaka Nicë gjeneralit. ***(1 pikë)***<br><br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi:<br>- shkruan për sjelljen e plakës Nicë kur në dysheme në mes të ulërimave të grave, mu në këmbët e gjeneralit, hedh thesin që e mbante në shpinë ***(1 pikë)***<br><br>- veçon ndonjë figurë stilistike ***(1 pikë)***<br><br>*Për një përgjigje më të plotë, me ndonjë shembull eventual* ***1 pikë***.<br><br>- tregon se plaka Nicë personifikon nënat e martirizuara dhe urrejtjen e pashuar të popullit ndaj agresorëve ***(1 pikë)***<br><br>- thekson shqetësimin që kishte plaka Nicë për gjeneralin dhe gjestin simbolik të hedhjes së eshtrave në këmbët e gjeneralit me ç' gjë e gjykon dhe e ekzekuton dënimin për kolonelin Z. ***(1 pikë)***<br><br>*Për një përgjigje më të plotë dhe me stil* ***1 pikë.***<br>**Gjithsej 6 pikë** |
| **Kërkesa** | Nxënësi thekson: |

| | |
|---|---|
| **5.** | - fatin e keq të plakës Nicë, pasi që i kishin vrarë të shoqin dhe i ishte zhdukur vajza ***(1 pikë)***<br>- se gjenerali kishte ardhur në Shqipëri së bashku me një prift për t'i mbledhur eshtrat e një ushtrie të vrarë gjatë Luftës së Dytë Botërore. ***(1 pikë)***<br>**Gjithsej 2 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| Origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil.<br><br>**3 pikë**<br><br>Origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale. | Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), i kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve ***për*** dhe ***mbi***, përemrit ***i vet/ i tij***, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: ***lidhur me këtë, duke marrë parasysh*** dhe i përemrave: ***që, i cili, e cila, të cilët*** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.<br><br>**2 pikë**<br><br>Respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i | Lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve.<br><br>**1 pikë** | Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët).<br><br>**2 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **2 pikë** | shkronjave ***r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë***, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ***ë***, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja ***j***).<br><br>**2 pikë**<br><br>**Gjithsej 4 pikë** | | |
| Përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil.<br><br>**1 pikë** | Respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve ***për*** dhe ***mbi***, përemrit ***i vet/ i tij*****,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit ***lidhur me këtë, duke marrë parasysh*** dhe i përemrave: ***që, i cili, e cila, të cilët*** etj.).<br><br>**1 pikë**<br><br>Respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, | | Ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit.<br><br>**1 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ***ë***, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja ***j***).<br>**1 pikë**<br><br>**Gjithsej  2 pikë** | | |

**Skema për vlerësimin e esesë: Lexoj edhe atë që (nuk) më duhet**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi tregon çfarë dëshiron të lexojë ***(1 pikë)*** dhe përse.<br>***(1 pikë)***<br><br>*Për një përgjigje më të plotë dhe me stil* ***1 pikë.***<br><br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi kumton asociacionet e veta për fjalën lektyrë. **(*1 pikë)***<br><br>*Për një përgjigje më të plotë dhe me stil* ***1 pikë.***<br><br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi cek titullin e veprës letrare ***(1 pikë)*** dhe me argumente kumton mendimin e vet PËR leximin e lektyrës ose KUNDËR tij.<br>***(1 pikë)***<br><br>*Për një përgjigje më të plotë dhe me stil* ***1 pikë.***<br><br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi shkruan titullin e epit dhe këngës epike ***(1 pikë)*** në bazë të të cilëve e argumenton qëndrimin e vet për këto lloje letrare.<br>***(1 pikë)***<br><br>*Për një përgjigje më të plotë dhe me stil* ***1 pikë.***<br><br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi kumton qëndrimin e vet të përpjekjes së afrimit të veprave letrare me vlerë për nxënësit sipas shëmbullit.<br>***(1 pikë)*** |

| | |
|---|---|
| | *Për një përgjigje më të plotë dhe me stil* ***1 pikë.***<br><br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi jep propozim/ propozime si të nxiten nxënësit që t'i lexojnë veprat e parapara me programin e lëndës. ***(1 pikë)***<br><br>*Për një përgjigje më të plotë dhe me stil* ***1 pikë.***<br><br>**Gjithsej 2 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| Origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil.<br><br>**3 pikë**<br><br>Origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, | Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), i kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve ***për*** dhe ***mbi***, përemrit ***i vet/ i tij***, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: ***lidhur me këtë, duke marrë parasysh*** dhe i përemrave: ***që, i cili, e cila, të cilët*** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.<br><br>**2 pikë**<br><br>Respektimi i normës | Lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve.<br><br>**1 pikë** | Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët).<br><br>**2 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale.<br><br>**2 pikë** | drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave ***r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë***, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja ***j***).<br><br>**2 pikë**<br><br>**Gjithsej 4 pikë** | | |
| Përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil.<br><br>**1 pikë** | Respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve ***për*** dhe ***mbi***, përemrit ***i vet/ i tij,*** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit ***lidhur me këtë, duke marrë parasysh*** dhe i përemrave: ***që, i cili, e cila, të cilët*** etj.).<br><br>**1 pikë**<br><br>Respektimi i normës drejtshkrimore me | | Ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit.<br><br>**1 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | gabime të pakta<br>(p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ***ë***, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja ***j***).<br>**1 pikë**<br><br>**Gjithsej 2 pikë** | | |